

## MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË PUKË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Pukë me objekt: Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publik, funksionimi i policisë bashkiake, etj. dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 135, datë 25.9.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 581/9 , datë 25.9.2012 , dërguar z. **Beqir ARIFAJ**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### A. MASA ORGANIZATIVE

**A.1.** Të merren masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të dërguara me shkresat nr. 283/6 dhe nr. 283/7, datë 27.10.2010.

**Menjëherë**

**A.2.** Të merren masa për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Për këtë:

- Të rishikohet struktura organizative me synim reduktimin e numrit të punonjësve në përputhje me mundësitë financiare të bashkisë.

-Të rishikohet rregullorja e funksionimit të brendshëm të institucionit, me qëllim që të mundësojë detyra të qarta dhe rregulla për funksionimin e njësive vartëse si: Çerdhja dhe Konvikti i shkollës.

- Të ngrihet njësia e auditimit të brendshëm si strukturë që jep siguri për funksionimin e kontrollit të brendshëm.

- Të krijohet regjistri i aktiveve të qëndrueshme ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj, sipas kërkesave të Kap. III-të të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

**Deri më datë 30.10.2012**

**A.3.** Të evidentohen debitorët për vitin 2011, të kontabilizohen detyrimet dhe të kërkohet arkëtimi i shumës **536,190 lekë** nga 5 subjektet taksa pagues:

- sh.p.k. për 295,270 lekë;
- sh.p.k. për 121,680 lekë;
- sh.p.k. për 51,620 lekë;
- për 46,000 lekë dhe
- për 21,620 lekë,

të cilët nuk kanë përfituar në vitin 2010 nga ligji nr. 10418, datë 21.4.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjesë të borxhit tatimor dhe doganor".

**Menjëherë**

**A.4.** Nga Zyra e Taksave Vendore të merren masat e nevojshme, që në përputhje me kërkesat ligjore, për evidentimin dhe vjeljen e detyrimeve lokale, të hapen regjistrat përkatës për bizneset, për tokën bujqësore, për taksën e ndërtesës dhe tarifat për familjarët.

**Menjëherë**

**A.5.** Për personin fizik ■ që ushtron aktivitetin e saj në objektin “Tregu i shitjes me pakicë”, të zbatohen procedurat ligjore për rregullimin e marrëdhënieve procedurale të qirasë, pasi ka paguar detyrimet pa patur kontratë qiraje.

**Menjëherë**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.**

Të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit me vlerë **3,051,597 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

**B.1.** Për 21 persona në vlerën **564,000 lekë**, për përfitim të padrejtë shpenzime udhëtim e dieta, në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

**Deri më 30.12.2012**

**B.2.** Për Sekretarine e Këshillit Bashkiak dhe 15 këshilltarë në vlerën **256,000 lekë**, për përfitim të padrejtë shpenzime udhëtim e dieta, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”.

**Deri më 30.12.2012**

**B.3.** Për z. ■ me detyrë ish-Kryetar Bashkie për vlerën **60,000 lekë**, për përfitim bonus në mënyrë të pa drejtë, për periudhën janar-shkurt 2010.

**Deri më 30.12.2012**

**B.4.** Për 3 persona në vlerën **311,448 lekë**, përkatësisht:

- zj. ■ për vlerën 103,416 lekë;
- z. ■ për vlerën 104,016 lekë dhe
- z. ■ për vlerën 104,016 lekë,

për përfitim të pa drejtë pagë për vitin 2010 e 2011, në kundërshtim me kërkesat e lidhjes nr. 4 “Klasifikimi i vendeve të punës për nëpunësit civil të bashkisë dhe qarqeve dhe për nëpunësit e komunave”, lidhjes nr. 2 “Nivelet e pagave për nëpunësit civil, në bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe nëpunësit e komunave”, kolona 7, e VKM nr. 598, datë 27.04.2009 “Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 02.07.2008”.

**Deri më 30.12.2012**

**B.5.** Zyra e Taksave Vendore, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për vjeljen e detyrimeve debitoare të vitit 2011 nga 25 subjekte për shumën **1,085,779 lekë**, në zbatim të kërkesave të neneve 4/2, 17/3 e 34 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar dhe nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

**Deri më 30.12.2012**

**B.6.** Për 3 persona në vlerën 318,000 lekë dhe përkatësisht:

- z. ■ me vlerë 106,000 lekë;
- z. ■ me vlerë 106,000 lekë dhe
- zj. ■ me vlerë 106,000 lekë,

me cilësinë e anëtarit/es të njësisë së prokurimit, kanë llogaritur gabim fondin limit në tenderët e vitit 2010 me objekt: “Blerje dru zjarri”, “Blerje bukë” dhe “Blerje ushqimesh”.

**Deri më 30.12.2012**

**B.7.** Të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për arkëtimin e shumës **80,730 lekë** nga personi fizik ■■■ për detyrime kontraktore dhe penaltitetet të papaguara për objektet e marra me qira për vitet 2010-2011.

**Deri më 30.12.2012**

**B.8.** Të llogariten detyrimet debitore për vitet 2010-2011, të kontabilizohen dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e tyre si dhe të kërkohet arkëtimi i shumës **240,617 lekë** për 9 subjektet:

z. ■■■ dhe z. ■■■ për 2,250 lekë, z. ■■■ për 25,480 lekë, z. ■■■ për 1,574 lekë, z. ■■■ për 20,864 lekë, z. ■■■ për 113,113 lekë, z. ■■■ për 18,545 lekë, z. ■■■ për 8,824 lekë, z. ■■■ për 47,949 lekë dhe zj. ■■■ për 2,018 lekë, kjo si rezultat i llogaritjes gabim të kostos mesatare të ndërtimit prej 28,092 lekë/m<sup>2</sup>, kur kjo kosto për qytetin e Pukës për vitin 2010 ka qenë 30,435 lekë/m<sup>2</sup> dhe për vitin 2011 ka qenë 30,628 lekë/m<sup>2</sup>.

**Deri më 30.12.2012**

**B.9.** Për 3 persona në vlerën **94,395 lekë** dhe përkatësisht, zj. ■■■ për vlerën 31,465 lekë, z. ■■■ për vlerën 31,465 lekë, zj. ■■■ për vlerën 31,465 lekë, me cilësinë e anëtarit/es të njësisë së prokurimit, kanë llogaritur gabim fondin limit në tenderin e vitit 2011 me objekt: "Blerje bukë".

**Deri më 30.12.2012**

**B.10.** Për 3 persona në vlerën **40,628 lekë** dhe konkretisht:

- z. ■■■ për vlerën 13,543 lekë;
- zj. ■■■ për vlerën 13,543 lekë dhe
- zj. ■■■ për vlerën 13,543 lekë,

me cilësinë e anëtarit/es të komisionit të vlerësimit të ofertave, kanë pranuar preventivin e operatorit ekonomik fitues, në të cilin, në 3 zëra punimesh analizat teknike të çmimeve janë hartuar në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 8.5.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit".

**Deri më 30.12.2012**

## **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549 datë 11.11.1999 "Statusi i nënpunësit civil" dhe pikën 1 e 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13.06.2000 "Për disiplinën në shërbimin civil", kërkohet të fillohen procedurat për dhënien e masës disiplinore:

**"Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët, për një periudhë nga 30 ditë deri në një vit, neni 25, pika 3 germa ç**

**1. Për Zj. ■■■** me detyrë ish-Përgjegjëse e Seksionit të Financës, aktualisht me detyrë përgjegjëse e Zyrës Ekonomike në Ndërmarrjen Ujësjellës-Kanalizime, ndërmarrje në varësi të bashkisë, me motivacionin:

- Për moszbatim të pikës 3 të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", duke i shkaktuar buxhetit të bashkisë një dëm ekonomik për vlerën **820,000 lekë**, problem ky i trajtuar hollësisht në procesverbalin nr. 1, datë 28.06.2012.

- Në cilësinë e kryetares së komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, nuk ka zbatuar për 23 raste, me vlerë totale **1,769,960 lekë**, kërkesat e pikës 2, kreu IV-të, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar dhe të pikës 5 të UAPP nr. 2, datë 18.02.2008 "Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël", i ndryshuar.

**“Vërejtje me paralajmërim”, neni 25, pika 3, germa b**

**1. Për zj. ■■■** me detyrë juriste, me motivacionin:

- Për moszbatim të VKM nr. 598, datë 27.04.2009 dhe të VKM nr. 693, datë 18.08.2010, sepse në cilësinë e juristes së bashkisë ka firmosur si të bazuar në ligj 2 (dy) projektvendime të kthyer në vendime nga Këshilli Bashkiak “Për strukturën, numrin e punonjësve si dhe pagat për vitin 2010 e 2011”, duke i shkaktuar një dëm ekonomik buxhetit të bashkisë për vlerën **311,448 lekë**, trajtuar në mënyrë të hollësishme në procesverbalin nr. 2, datë 28.06.2012.

- Në cilësinë e anëtares të njësisë së prokurimit, në tenderin e zhvilluar në vitin 2011 me objekt “Blerje buke” ka llogaritur gabim fondin limit, duke i shkaktuar një dëm buxhetit të bashkisë për vlerën **94,395 lekë**, trajtuar në mënyrë të hollësishme në procesverbalin nr. 5, datë 02.07.2012.

- Për moszbatim të VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfiletozë të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 739, datë 01.07.2009 në dhënien me qira të tre objekteve.

**2. Për zj. ■■■** me detyrë përgjegjëse e Zyrës së Financës në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, lidhur me:

- Dëmin ekonomik me vlerë **412,395 lekë**, shkaktuar buxhetit të bashkisë si rezultat i llogaritjes gabim të fondit limit në tenderat e zhvilluar në vitin 2010 me objekte “Blerje dru zjarri”; “Blerje bukë”; “Blerje ushqime” dhe për vitin 2011 me objekt “Blerje bukë”.

**3. Për zj. ■■■** me detyrë përgjegjëse e Zyrës së Taksave dhe Vjeljes së të Ardhurave, lidhur me,

- Për moszbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, duke krijuar një të ardhur të munguar bashkisë me vlerë **536,190 lekë**.

***Shënim:***

Për ish-punonjësit e mëposhtëm:

1. ■■■ me detyrë Jurist i Bashkisë për periudhën 01.01. 2010 deri 12.8.2010.

2. ■■■ me detyrë përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave dhe Vjeljes të të Ardhurave për periudhën korrik 2010-qershor 2011.

3. ■■■ me detyrë përgjegjës i Seksionit të Burimeve Njerëzore për periudhën 2010-2011.

4. ■■■ me detyrë përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Urbanistikës, për periudhën 2010-2011, nuk rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimin e tyre.

Në kushtet kur mos ushtrimi i detyrës administrative nga ana e tyre ka ndikuar në funksionimin administrativ të institucionit, atëherë ngarkohet Bashkia të njoftojë Departamentin e Administratës Publike për rezultatet e auditimit të KLSH për këto persona.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatos Gjyzezi, Ramadan Zejnuni dhe Josif Lile. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**